

**STATUT**  
**I SHOQERISE "REXHA-CO" sh.p.k.**

**KAPITULLI I**

**Dispozita te Pergjitheshme**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "REXHA-CO" sh.p.k., eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga ortaket e saj bazuar ne "Ligjin" Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

**KREUI**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**NENI 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 29.12.2020, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Shoqeria do te emerohet "REXHA-CO" sh.p.k.

Themeluesit e shoqërisë janë:

**1.- Z. Errik Rexha**, i biri i Gezim-it, shtetas shqiptar, lindur më datë 19.10.1992, në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 030593504, identifikuar me nr. Personal J21019049B.

**2.- Z. Gersi Rexha**, i biri i Gezim-it, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 29.12.1993, banues ne Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr.031359109, identifikuar me nr. Personal J31229047T.

**NENI 2**

**Objekti i Shoqerise**

- Ushtrimin e aktivitetit per ndërtim objketesh shumë katëshe, rezidenciale, rrugësh, rikonstruksione dhe restaurime, punime te dheut, punime betoni, murature, punime te shembjes, punime hidraulike, elektrike, punime gipsi, suvatime, ndertimi i kapanoneve industriale dhe bujqesore te te gjitha llojeve, punime elektrike dhe montimi te sistemeve te projektuara elektrike hidraulike, sisteme ngrohje- ftohje dhe mbrojtjes ndaj zjarrit, projektim, konsulence per ndertim e zbatim te veprave ndertimore publike dhe private, objekte turistike, ushtarake, kulturi, industriale dhe te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar;
- Ushtrimin e aktivitetit shitje-blerje materiale, objekte industrial, materiale elektrike dhe hidraulike, social-kulturore, bujqesore, turistike, hoteleri, kompletimin me instalime te brendshme te objekteve te ndertuara, marrjen dhe dhenien me qira te pajisjeve te ndertimit, te mjeteve te transportit per ndertim dhe tregetim te tyre. Furnizim, vendosje, sherbime, mirembajtje panele diellore.



- Importim, eksportim dhe tregetimin e te gjithave llojeve te materialeve, automjeteve me goma dhe zinxhire te tipeve te ndryshme te makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit publik, industrial, bujqesor, tregetar, kulturor, sportive te sherbimeve. Tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial, produkteve bujqesore, ushqimore, materiale ndertimi, elektrike, hidraulike, sisteme ngrohje ftohje dhe materiale te sistemit te mbrojtjes nga zjarri, pesticidet, pajisje elektronike, konfeksione
- Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban; projektim arkitektonik; projektim strukturash mbajtese beton arme, metalike; projektim rrugesht te te gjitha niveleve, ura, tunele, nenkalime, autostrada, trase hekurudhore mbi dhe nentoke, portesh, aeroportesh, heliportesh; projektim linjash dhe sistemesh se prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike: Linja mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, centrale; projektim ujesjelles, kanalizime, vepra ujitjeje, vepra bonifikuese e ujore, vepra kullimi, impiante vaditese, diga, dampa,etj; projektim vepra naftesjelles, gasjelles, etj; projektim fotogrametrik, hartografik, topografik; konsulenca tekniko-ekonomike sipas kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi, qe nuk permendet me siper. Studime fizibiliteti.vleresime mjedisore. Grumbullimi dhe depozitimi i materialeve inerte ndertimore jo te rrezikshme.
- Cdo aktivitet tjeter te nevojshem per realizimin e qellimit te Shoqerise.

### **NENI 3 Adresa e Shoqerise**

Shoqeria do te kete Seline e saj në Tirane, Kashar, Rruga “Sokrat Miho”, Pallati Pienvis, Seksioni 1, Bodrum.

Selia e shoqerise mund te transferohet.

### **NENI 4 Kohezgjatja e Shoqerise**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar ,periudhe e cila mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Ortakeve.

## **KREU II Kapitali**

### **NENI 5 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar per vazhdimin e aktivitetit te shoqerise eshte ne shumen 100 Leke, qe i takon ortakeve themelues si me poshte:

1. Ortaku **Z. Errik Rexha**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 50 Leke që përbejne 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2.Ortaku **Z. Gersi Rexha**: Zoterues i 1 (nje) Kuote me vlerë të përgjithshme 50 Leke që përbejne 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.




## NENI 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Mbledhja e asamblese së ortakëve është organi vendimtar për rritjen dhe zvogelimin e kapitalit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë, por vete ortaku pranon rivlersimin e pjesës së tij takuese në shoqëri në proporcion me rritjen e kapitalit.

Zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## NENI 7 Transferimi i kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë në çdo kohë, me një vendim unanim, për transferimin e kuotave përmes shitjes, dhurimit apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Për çdo formë të transferimit të kuotave (duke përfshirë edhe transferimin pa kundërshtim), ortakët ekzistues të Shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotat e projektuara për t'u transferuar, në përputhje me rregullat e parashikuara në dispozitat në vijim ("E Drejta e Parablerjes").

Ortaku, që ka për qëllim të shesë apo të transferojë kuotën e tij, duhet të njoftojë me shkrim ("Njoftimi") Administratorin në adresën e selisë së Shoqërisë. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat e Ortakut që ofron kuotën dhe të përfituesit të mundshëm të saj, kuotën që do të transferohet, kushtet e transferimit, duke përfshirë çmimin dhe mënyrat e pagesës.

Administratori brenda 7 (shtatë) ditësh nga marrja e Njoftimit për transferimin, do të njoftojë Ortakun/et e Shoqërisë në lidhje me transferimin në fjalë.

Ortakët, të cilëve ju drejtohet Njoftimi si më sipër, duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotën së cilës i referohet Njoftimi, duke i dërguar Ortakut ofrues dhe Administratorit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e Njoftimit, deklaratën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.

Në rast se Ortakët e tjerë dhe Ortaku transferues nuk bien dakord me çmimin e kuotës së propozuar nga ky i fundit për tu transferuar, apo me vlerën e tregut në rastin e transferimit të kuotës pa kundërshtim, ata do të caktojnë një ekspert të pavarur nga ortakët për të përcaktuar çmimin sipas vlerës së tregut, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Pas njoftimit të çmimit të kuotës të përcaktuar nga eksperti, ortakët brenda 15 (pësemëdhjetë) ditësh duhet të njoftojnë Administratorin dhe ortakun transferues lidhur me interesimin e tyre për të blerë kuotën me çmimin e përcaktuar nga eksperti.

Nëse asnjë nga Ortakët nuk ka për qëllim të blejë kuotën e ofruar sipas mënyrave dhe kushteve të përshkruara ose në rast se askush prej Ortakëve nuk njofton brenda 30 (tridhjetë) ditëve, Ortaku transferues do të jetë i lirë të transferojë kuotën e tij të blerësit të përcaktuar në Njoftimin dërguar Ortakëve të tjerë.

Transferimi do të konsiderohet si i miratuar në heshtje nëse Ortakut transferues nuk i paraqitet asnjë njoftim për ushtrimin e së drejtës së parablerjes brenda 30 (tridhjetë) ditësh, ose kur nuk është arritur asnjë

marrëveshje brenda gjashtëdhjetë 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të transferimit në fjalë nga Ortaku transferues.

E Drejta e Parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë kuotën e ofruar.

Asnjë Ortak nuk mund të vendosë mbi kuotat ndonjë peng, garanci, hipotekë apo çdo lloj barre tjetër apo t'i vendos si objekt i një të drejte për t'i barrësuar pa marrë më parë miratimin më shkrim të Ortakut tjetër.

Asnjë Ortak nuk do të bëhet palë e një marrëveshje në lidhje me të drejtën e votës që lidhet me kuotën e tij apo të interesave të tjera që zotëron në Shoqëri.

### **KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **NENI 8 Organi Vendimarrës**

Shoqëria është e organizuar në organet e mëposhtme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqërisë
- 2- Bordi Drejtues
- 3- Administratori

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme në përputhje me nenin 10 dhe 11 të statutit:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarja e fitimit/humbjes vjetore;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) emërimi dhe shkarkimi i anetareve të Bordit Drejtues
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates. Administrastoret e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## NENI 9

### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## NENI 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 75% për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se tre të katërtat ose 75% të numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## NENI 11

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me 75% ose me 2/3 e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës çështjet e mëposhtme:

1. për ndryshimin e statutit
2. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
3. shpërndarjen e fitimeve
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, sipas nenit 10 pika 1, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- h) emërimin dhe shkarkimin e anetareve të Bordit Drejtues të shoqërisë.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### NENI 12

##### Përgjithshme nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënie ose jo të përfitimeve të reja.

#### NENI 13

##### Administrimi

1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë për një afat 5 vjeçar nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie prane QKB-sc.

- **Z. Errik Rexha**, i biri i Gezim-it, shtetas shqiptar, lindur më datë 19.10.1992, në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 030593504, identifikuar me nr. Personal J21019049B., e cila në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretet në gjithë veprimtarinë e shoqërisë.

#### NENI 14

##### Kompetencat e Administratorëve

Administratori/ët ka të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare, të nënshkruajë kontrata apo çdo lloj akti tjetër të domosdoshëm që lidhet me aktivitetin e shoqërisë pa kufizim;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e curisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme dhe përpara Bordit Drejtues në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblesë të Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## NENI 15

### Përgjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Cdo veprim i administratorit jashtë tagrave të tij të shprehura specifikisht në ligj dhe/ose në këtë statut është i pavlefshëm.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

1.) administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Kreu IV**  
**BORDI DREJTUES**

**NENI 16**  
**Objektivat**

1. Bordi Drejtues eshte organi me i larte drejtues dhe organizativ i shoqerise.
2. Ky Bord eshte krijuar per te ndihmuar, lehtesuar dhe drejtuar menaxhimin e aktivitetit te perditshme te shoqerise ne te gjitha aspektet.
3. Funkzioni i Bordit Drejtues ka si qellim mbarevajtjen, kontrollin e aktivitetit te perditshem te shoqerise si dhe te administratorit te saj.

**NENI 17**  
**Pranimet**

1. Anetar i Bordit Drejtues do te quhet cdo individ aktiv i cili zgjedhet dhe miratohet nga nje procedure e rregullt e deklaruar me pare nga perfaqesuesit e ortakeve te shoqerise.
2. Me proceduren e perzgjedhjes se aplikimit dhe pranimet per anetar ne Bordin Drejtues ngarkohen perfaqesueset e ortakeve te shoqerise, ku pranimi i cdo anetar duhet te marri miratimin e 2/3 te ortakeve.
3. Zgjedhja e anetareve te Bordit behet nje here ne vit.
4. Numri i pergjithshem i anetareve te Bordit te ri Drejtues do te jete deri ne 5 veta.

**NENI 18**  
**Te Drejtat Dhe Pergjegjesite**

1. Cdo anetar ka per detyre te marre pjese aktive ne drejtimin dhe mbarevajtjen e aktiviteve te perditshem te shoqerise.
2. Cdo anetar ka te drejte te mireinformohet per pozicionin qe duhet te kete ne cdo suate ku ai merr persiper pergjegjesine te drejtoje nje eveniment te caktuar perfshire kjo ne funksionin e aktiviteve te shoqerise
3. E drejta e fjales dhe degjimit i rezervohet cdo anetari perkundrejt vleresimit te tij nga anetaret e tjere te Bordit Drejtues.
4. Cdo anetar ka te drejte te hedhe ne shqyrtim dhe diskutim cdo eveniment ekzistues te aktivitetit te perditshme te shoqerise.
5. Imuniteti i Bordit Drejtues eshte nje e drejte qe mund t'i percillet cdo anetari te Bordit kur ai ndodhet perballe nje suate qe kerkon nderhyrjen ose bashkeveprimin e menjehershem te Bordit Drejtues. Me rastin e pare ky aksion duhet te deklarohet per te marre miratimin apo sygjerimet e ortakeve te shoqerise.
6. Cdo anetar i bordit ka te drejten te komunikojte direkt me ortaket e shoqerise, per te kerkuar mendimin e tyre per nje ceshtje me interes per te gjitha.
7. Cdo anetar i bordit drejtues ka te drejten te monitoroje dhe te korrigoje qendrimet e administratorit/ve



gjate aktivitetit te perditshem te punes kur keto qendrimet shkelin kompetencat e dhena administratorit/ve nga ky statut. Korrigjimi kryhet me terheqjen e vemendjes apo me sygjerimin per shkarkimin nga detyra e administratorit/ve te shoqerise, sygjerim ky qe percillet tek ortaket e shoqerise.

8. Anetaret e bordit, kane te drejten te negociojne me individe apo subjekte te ndryshme per ti sjelle shoqerise sherbime te reja ose per te financuar ato egzistuese.

9. Cdo anetar i Bordit duhet te jete pergjegjes per ruajtjen e personalitetin te tij, konfronto cdo rrethane te krijuar.

10. Cdo anetar i Bordit Drejtues e ka per detyre te percoje ne shoqeri me menyren me te mire dhe jo te drejtperdrejte objektivat dhe qellimin e e politikave te shoqerise duke nderhyre me menyren me te mire.

11. Cdo anetar i bordit ka te drejte te nxjerre ne pah dhe terheqi vemendjen nje kolegu brenda bordit per sjellje te papergjegjshme ose jokohere me rregulloret e shoqerise. Sjelljet e papergjegjshme te perseritura jane subjekt marrje masash qe mund te cojne deri ne perjashtim nga bordi drejtues.

### **NENI 19 Procedurat**

1. Votimi eshte procesi me kryesor i vendmarjes se veprimeve nga ana e Bordit Drejtues. Eshte e detyrueshme pjesemarrja e cdo anetari duke dhene mendimin e tij: po, jo, abstenim

2. Cdo anetar ka te drejten hedhjes se nje ceshtjeje per votim si dhe te mbrojtjes dhe te analizimit te vendimit te tij.

3. Cdo anetar ka te drejten e nje vote.

4. Procedura e votimit percaktohet dhe drejtohet vetem nga ortaket e shoqerise me miratimin qe me pare te dy ose me shume anetareve te tjere te Bordit Drejtues.

5. Votimi merr vleren aktive vetem kur nga numerimi, rezultojne se me shume se 2/3 e votave perkrahin ose hedhin poshte temen e dhene per shqyrtim.

6. Cdo votim nuk mund te zgjase me shume se tre dite. Ne qofte se pjesemarrja brenda afatit nuk kalon 2/3 e anetareve aktive te Bordit Drejtues, me miratim ose shtyhet edhe 2 dite te tjera afati.

### **Kreu V Viti financiar-ekspertet**

### **NENI 20 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **NENI 21 Ekspertet**



Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Kreu VI**

### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

#### **NENI 22**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 23**

#### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **NENI 24**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 25**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

Ky Statut eshte i pergatitur ne dy (2) kopje te barazvlefshme ne gjuhen shqipe me nga 11 (njembedhjete) faqe secila.

**ORTAKET E SHOQERISE**

**Z. Errik Rexha**

*Errik Rexha*



**Z. Geris Rexha**



*Geris Rexha*